

VENDIM
Nr. 5, datë 13.1.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E
RREZIKUT TË KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË
HUAJA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në nenin 13, pika 6, togfjalëshi “nga 12 marsi 2020 deri në 31 dhjetor 2020”, ndryshohet në “nga 12 marsi 2020 deri në 31 mars 2021”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko